

PHILIPS

HR2531, HR2532
HR2533, HR2534
HR2535, HR2536
HR2537, HR2538

Manuali i përdorimit

TABELA E PËRMBAJTJES

E rëndësishme	3
Hyrje	6
Përshkrim i përgjithshëm	6
Përpara përdorimit të parë	8
Përgatitja për përdorim	8
Përdorimi i pajisjes	8
Përzierësi i dorës	8
Grirësja XL (vetëm HR2537)	
Grirësja kompakte (vetëm HR2532, HR2533, HR2535, HR2536, HR2537, HR2538)	11
Rrahësja (vetëm HR2533, HR2536, HR2537, HR2538)	14
Shtypësja e patateve (vetëm HR2538)	17
Pastrimi	19
Vendruajtja	22
Riciklimi	22
Garancia dhe mbështetja	22
Zgjidhja e problemeve	22

E rëndësishme

Lexojeni me kujdes këtë manual përdorimi përpara se ta vini në punë pajisjen, si dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Rrezik

- Mos e zhytni kurrë njësinë e motorit në ujë apo në ndonjë lëng tjetër, as mos e shpëlani në rubinet. Përdorni vetëm një leckë të lagësht për të pastruar njësinë e motorit.

Paralajmërim

- Kontrolloni nëse voltazhi i përcaktuar në pajisje përkon me voltazhin e linjës lokale përpara se ta vini në punë pajisjen.
- Mos e përdorni pajisjen nëse spina, kordoni elektrik apo pjesë të tjera janë të dëmtuara ose kanë krisje të dukshme.
- Nëse kordoni elektrik është i dëmtuar, ai duhet ndërruar nga “Philips”, agjenti i tij i servisit apo persona me kualifikim të ngjashëm, në mënyrë që të shmangen rreziqet.
- Mos i prekni në asnjë mënyrë tehet prerëse të njësisë së thikave, veçanërisht kur pajisja është në prizë. Tehet prerëse janë shumë të mprehta.
- Mos e përdorni asnjëherë njësinë e thikave të grirëses pa tasin e grirëses.
- Për të shmangur spërkatjen, zhyteni gjithmonë shufrën ose rrahësen e përzierësit (vetëm për lloje të posaçme) brenda tek përbërësit përpara se të ndizni pajisjen, në veçanti kur përziëni ushqime të nxehta.
- Nëse një nga njësitet e thikave ngec, hiqeni pajisjen nga priza përpara se të hiqni përbërësit që bllokojnë njësitet e thikave.

- Bëni kujdes kur hidhni lëngje të nxehta në gotën e masave, pasi lëngjet e nxehta dhe avulli mund të shkaktojnë djegie.
- Kjo pajisje është parashikuar vetëm për përdorim të zakonshëm në shtëpi. Ajo nuk është menduar për përdorim në ambiente si kuzhinat profesionale apo dyqane, zyra, ferma ose ambiente të tjera pune. Ajo as nuk është menduar për përdorim nga klientët në hotele, motele, ambiente për fjetje dhe mëngjes dhe mjedise të tjera banimi.
- Asnjëherë mos përzieni me pajisjen përbërës të fortë si për shembull kubat e akullit.
- Kjo pajisje nuk duhet përdorur nga fëmijët. Mbajeni pajisjen dhe kordonin larg vendeve ku mund të arrihet nga fëmijët.
- Pajisjet mund të përdoren nga fëmijë me aftësi të reduktuara fizike, shqisore apo mendore, apo që kanë mungesë përvoja dhe njohurish vetëm nëse u kushtohet mbikëqyrja e duhur apo u jepen udhëzime në lidhje me përdorimin e sigurt të pajisjeve, si dhe nëse kuptojnë rreziqet e përfshira.
- Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen.
- Shkëputeni gjithmonë pajisjen nga priza nëse e lini të pamonitoruar dhe përpara se ta montoni, çmontoni, ta vendosni në ruajtje ose përpara se ta pastroni.
- Përpara se ta përdorni pajisjen për herë të parë, pastrojeni mirë pjesët që bien në kontakt me ushqimin. Shihni udhëzimet dhe tabelën e pastrimit që jepen në manual.
- Hiqeni gjithmonë pajisjen nga priza përpara se të ndërroni aksesoret ose përpara se t'u afroheni pjesëve që lëvizin gjatë përdorimit.

Kujdes

- Mos e përdorni pajisjen me asnjë nga aksesorët për më gjatë se 3 minuta pa ndërprerje. Lëreni pajisjen të ftohet për 15 minuta përpara se të vazhdoni përzjerjen.
- Asnjë nga aksesorët nuk është i përshtatshëm për përdorim në mikrovalë.
- Mos përdorni kurrë aksesorë apo pjesë nga prodhues të tjetër apo që nuk rekomandohen konkretisht nga "Philips". Nëse përdorni aksesorë apo pjesë të tilla, garancia juaj bëhet e pavlefshme.
- Mbajeni njësinë e motorit larg nxehtësisë, zjarrit, lagështisë dhe papastërtive.
- Përdoreni këtë pajisje vetëm për qëllimin e saj të synuar siç tregohet në manualin e përdorimit.
- Mos e mbushni asnjëherë gotën e masave, tasin e grirëses XL (vetëm për lloje të posaçme) ose tasin e grirëses kompakte (vetëm për lloje të posaçme) me përbërës që janë më të nxehtë se 80°C/175°F.
- Mos i tejkaloni sasisë dhe kohët e përzjerjes të përcaktuara në tabelë.
- Pastrojeni njësinë e thikave të shufrës së përzjerësit në ujë të rrjedhshëm. Mos e zhysni asnjëherë në ujë njësinë elektrike.
- Pas pastrimit, lëreni shufrën e përzjerësit të thahet. Ruajeni horizontalisht ose me thikat e vendosura lart.
- Niveli i zhurmës: Lc = 85 dB(A)

Fushat elektromagnetike (EMF)

Pajisja Philips është në përputhje me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Hyrje

Urime për blerjen dhe mirë se vini pranë Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistroni produktin në faqen www.philips.com/welcome.

Përshkrim i përgjithshëm

Përzierësi i dorës

- 1 Butoni i ndezjes/fikjes
- 2 Njësia e motorit
- 3 Butoni i lirimit
- 4 Shufra e përzierësit me njësinë e thikës të integruar

Rrahësja (vetëm HR2533, HR2536, HR2537, HR2538)

- 5 Njësia bashkuese e rrahëses
- 6 Rrahësja

Gota e masave

- 7 Gota e masave

Shtypësja e patateve (vetëm HR2538)







- 8 Njësia bashkuese e shtypëses së patateve
- 9 Shtypësja e patateve
- 10 Fletët e shtypëses së patateve

Grirësja XL (vetëm HR2537)

- 11 Kapaku i grirëses XL
- 12 Njësia e thikave të grirëses XL
- 13 Tasi i grirëses XL

Grirësja kompakte (vetëm HR2532, HR2533, HR2535, HR2536, HR2537, HR2538)

- 14 Kapaku i grirëses kompakte
- 15 Njësia e thikave të grirëses kompakte
- 16 Tasi i grirëses kompakte



Përpara përdorimit të parë

- 1 Përpara se ta përdorni pajisjen për herë të parë, pastroni mirë të gjitha pjesët që do të bien në kontakt me ushqimin (shihni kapitullin "Pastrimi").



Shënim

- Sigurohuni që të gjitha pjesët janë plotësisht të thata përpara se të filloni përdorimin e pajisjes.

Përgatitja për përdorim

- 1 Lërimi përbërësit e nxehtë që të ftohen përpara se t'i përpunoni ato ose hidhni ato në gotën e masave (temperatura maksimale 80°C).
- 2 Pritni përbërësit e mëdhenj në copa me përmasa rreth 2 x 2 x 2 cm përpara se t'i përpunoni ato.
- 3 Montoni pajisjen në mënyrën e duhur përpara se të futni spinën në prizën elektrike.



Shënim

- Hapeni plotësisht të gjithë kordonin elektrik përpara se të ndizni pajisjen.
- Largoni të gjitha materialet e paketimit ose etiketat përpara përdorimit.

Përdorimi i pajisjes

Përdoreni këtë pajisje vetëm për përdorimin e parashikuar në shtëpi, sipas mënyrës së përshkrimit në këtë manual.



Kujdes

- Shmangni kontaktin me pjesët lëvizëse. Mbani duart dhe gishtat larg nga thikat prerëse dhe jashtë enës gjatë përdorimit ose ndërkohë që pajisja është e lidhur në korrent, për të parandaluar mundësinë e lëndimit të rëndë të njerëzve dhe/ose të dëmtimit të pajisjes.

Përzierësi i dorës

Përzierësi i dorës është parashikuar për:

- përzierjen e lëngjeve, p.sh. artikuj bulmeti, salca, lëngje frutash, supa, pije të përziera dhe pije me qumësht.
- përzierjen e përbërësve të butë, p.sh. brumë i rrahur petullash ose majonezë.


- bëren pure të përbërësve të zier, p.sh. për të përgatitur ushqimin e fëmijëve të vegjël.
- copëtimin e arrave, frutave dhe perimeve.

**Kujdes**


- Mos përpunoni përbërës të tillë si akulli, përbërësit e ngrirë ose frutat me bërthamë (fig. 1).

Sasitë e përzierjes dhe kohët e përpunimit


Përbërësit	Sasia e përzierjes	Ora
Fruta dhe perime	100 - 200 g	30 sek.
Ushqim për fëmijë, supa dhe salca	100 - 400 ml	60 sek.
Brumëra të holla	100 - 500 ml	60 sek.
Pije me qumësht dhe pije të përziera	100 - 500 ml	60 sek.




- 1** Montoni shufrën e përzierësit në njësinë e motorit (të dëgjoni një “klik”).




- 2** Hidhni përbërësit në gotën e masave.




- 3** Futni spinën e pajisjes në prizën elektrike.




- 4** Zhytni mbrojtësen e thikave plotësisht brenda në përbërës për të shmangur spërkatjen.




- 5** Ndizni pajisjen duke shtypur butonin e ndezjes/fikjes.



- 6** Lëvizni pajisjen ngadalë lart e poshtë dhe në formë rrethore për të përzier përbërësit.




- 7** Pasi të përfundoni përzierjen, hiqni pajisjen nga priza.




- 8** Hiqni shufrën e përzierësit duke shtypur butonin e lirimit.

! Kujdes


- Thikat janë të mprehta. Veproni me kujdes. Në fillim, hiqni gjithmonë spinën e pajisjes. Kurrë mos i prekni thikat vetë gjatë pastrimit ose kur hiqni ushqimet e ngecura tek thikat.



- 9** Për pastrim sa më të lehtë, shpëlani shufrën e përzierësit me ujë të ngrohtë menjëherë pas përdorimit. Mos e zhytni shufrën plotësisht në ujë.



- 10** Vendoseni shufrën në pozicion vertikal me mbrojtësen e thikave të vendosur lart dhe lëreni të thahet të paktën për 10 minuta përpara se ta vendosni në ruajtje.



Grirësja XL (vetëm HR2537)

Grirësja kompakte (vetëm HR2532, HR2533, HR2535, HR2536, HR2537, HR2538)

Grirësja XL dhe grirësja kompakte janë menduar për grirjen e përbërësve të tillë si arrat, mishi i papërpunuar, qepët, djathi i fortë, vezët e ziera, hudhra, erëzat, buka e thatë etj.



Kujdes

- Në fillim, hiqni gjithmonë spinën e pajisjes. Bëni shumë kujdes kur përdorni njësinë e thikave të grirësës, pasi tehet e prerjes janë shumë të mprehtë. Mbani gjithmonë njësinë duke e kapur nga shufra plastike në qendër. Mos i prekni kurrë direkt thikat. Bëni veçanërisht kujdes kur futni ose kur hiqni njësinë e thikave nga tasi i grirësës, kur zbrazni tasin e grirësës, kur hiqni ushqimet e ngecura tek thikat dhe gjatë pastrimit.
- Mos përpunoni përbërës të tillë si akulli, përbërësit e ngrirë ose frutat me bërthamë.


Sasitë e grirjes dhe kohët e përpunimit

	Përbërësit	Sasia e grirjes	Ora
Grirësja XL	Qepë, vezë	200 g	5 x 1 sek.
	Peshk	200 g	10 sek.
	Barishte	30 g	5 x 1 sek.
	Arra dhe bajame	200 g	30 sek.
	Çokollatë e zezë	100 g	20 sek.
	Kuba buke të thatë	80 g	30 sek.


	Përbërësit	Sasia e grirjes	Ora
Grirësja kompakte	Hudhra, qepë, vezë	100 g	5 x 1 sek.
	Peshk	120 g	5 sek.
	Barishte	20 g	5 x 1 sek.
	Arra dhe bajame	100 g	20 sek.




1 Vendosni njësini e thikave në tasin e grirës.




2 Hidhni përbërësit në tasin e grirës.




3 Vendosni kapakun e grirës mbi tasin e grirës.




- 4** Montoni njësinë e motorit në kapakun e grirëses (të dëgjoni një "klik").




- 5** Futni spinën e pajisjes në prizën elektrike.




- 6** Shtypni butonin e ndezjes/fikjes dhe lëreni në punë derisa të jenë prerë të gjithë përbërësit.




- 7** Pasi të përfundoni me grirjen, hiqni pajisjen nga priza.



- 8** Shtypni butonin e lirimit për të hequr njësinë e motorit nga kapaku i tasit.



9 Hiqni me kujdes kapakun e grirësës dhe njësinë e thikave (fig. 18).



10 Zbrazni jashtë përbërësit e grirë (fig. 19).

Rrahësja (vetëm HR2533, HR2536, HR2537, HR2538)

Rrahësja është menduar për rrahjen e ajkës/kremit, për rrahjen e të bardhave të vezëve, të ëmbëlsirave etj.



Këshillë

- Nëse dëshironi të përpunoni një sasi të vogël, kthejeni tasin paksa mënjane për një rezultat të shpejtë.
- Kur rrihni të bardha vezësh përdorni një tas të madh për rezultatin më të mirë. Për të arritur një rezultat të mirë, tasi dhe vegla duhet të jenë plotësisht pa yndyrë dhe nuk duhet të ketë të verdhë veze në të bardhat e vezëve.
- Kur rrihni ajkë/krem, përdorni gotën e thellë për të shmangur spërkatjen.




Shënim


- Mos e përdorni rrahësen për të përgatitur brumin ose përzierjen e kekut.

Sasitë e rrahjes dhe koha e përpunimit


Përbërësit	Sasia e rrahjes	Ora
Krem/ajkë	250 g	70-90 sek
Të bardha vezësh	4 x	120 sek




1 Montoni rrahësen në njësinë bashkuese të rrahëses (të dëgjoni një "klik").




2 Montoni njësinë bashkuese të rrahëses në njësinë e motorit (të dëgjoni një "klik").




3 Hidhni përbërësit në një tas.




4 Futni spinën e pajisjes në prizën elektrike.




5 Zhytni rrahësen brenda në përbërës.




6 Ndizni pajisjen duke shtypur butonin e ndezjes/fikjes.




7 Lëvizni pajisjen ngadalë lart e poshtë dhe në formë rrethore.



8 Pasi të përfundoni me rrahjen, hiqni pajisjen nga priza.




9 Shtypni butonin e lirimimit për të hequr njësine e motorit nga njësia bashkuese e rrahëses.




10 për të shkëputur rrahësen nga njësia bashkuese e saj tërhiqni rrahësen vertikalisht për poshtë jashtë njësise bashkuese.

Shtypësja e patateve (vetëm HR2538)


Përbërësit	Sasia e rrahjes	Ora
Patate	2 kg	40-60 sek




- 1** Montoni shtypësen e patateve në njësinë bashkuese të shtypëses së patateve, rrotulloni shtypësen e patateve në drejtimin kundërorar derisa të mbërthehet (të dëgjoni një "klik").




- 2** Për të montuar fletët e shtypjes në shufrën e patateve, rrotullojeni në drejtimin kundërorar derisa të mbërthehet.




- 3** Montoni njësinë bashkuese të shtypëses së patateve në njësinë e motorit.




- 4** Futni spinën e pajisjes në prizën elektrike.




5 Ulni shtypësen e patateve brenda një tasi me patate të ziera.



6 Ndizni pajisjen duke shtypur butonin e ndezjes/fikjes.



7 Lëvizni pajisjen ngadalë lart e poshtë dhe në formë rrethore.



8 Pasi të përfundoni me shtypjen e patateve, hiqni spinën e pajisjes nga priza.

Pastrimi



Kujdes

- Mos e zhytni njësinë e motorit, kapakun e grirëses kompakte, kapakun e grirëses XL, njësinë bashkuese të rrahëses dhe njësinë bashkuese të shtypëses së patateve në ujë ose në lëngje të tjera dhe as mos i shpëlani ato nën çezmë. Përdorni një leckë të lagur për t'i pastruar këto pjesë. Thikat e shufrës së përzierësit dhe mbrojtësja e tij mund të shpëlohen në çezmë. Të gjithë aksesoret e tjerë janë të përshtatshëm për t'u larë në enëlarëse.
- Mos përdorni asnjëherë sfungjerë gërvishtës, agjentë pastrimi gërryes ose lëngje agresive si p.sh. alkool, benzinë ose aceton për të pastruar pajisjen.


- 1 Hiqni spinën e pajisjes nga priza.
- 2 Shtypni butonin e lirimit në njësinë e motorit për të hequr aksesoren që keni përdorur.
- 3 Çmontoni aksesoren.
- 4 Shihni tabelat "Pastrimi" për udhëzime të tjera.



	✗	✗	✓
	✓	✗	✓
	✗	✗	✓
 HR2533 HR2536 HR2537 HR2538	✓	✓	✓
 XL Compact	✗	✗	✓
	✓	✓	✓
 HR2537 HR2532 HR2533 HR2535 HR2536 HR2537 HR2538	✓	✓	✓



	✓	✓	✓



Vendruajtja

- 1 Mbështilni kordonin elektrik lirshëm përreth bazamentit të njësisë së motorit.
- 2 Vendosni pajisjen në ruajtje në një vend të freskët dhe të thatë larg nga drita direkte e diellit apo burimet e tjera të nxehtësisë.

Riciklimi



- Ky simbol do të thotë që produkti nuk duhet të hidhet me mbeturinat normale të shtëpisë (2012/19/BE).
- Ndiqni rregullat shtetërore për hedhjen e veçuar të produkteve elektrike dhe elektronike. Hedhja e duhur ndihmon në parandalimin e pasojave negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Garancia dhe mbështetja

Nëse ju duhet informacion apo mbështetje teknike, vizitoni **www.philips.com/support** ose lexoni fletëpalosjen e posaçme të garancisë botërore.

Zgjidhja e problemeve

Ky kapitull përmbledh problemet më të shpeshta që mund të hasni me pajisjen. Nëse nuk keni mundësi ta zgjidhni problemin me informacionin e mëposhtëm, vizitoni **www.philips.com/support** për një listë të pyetjeve të shpeshta ose kontaktoni me qendrën e shërbimit të klientit për shtetin tuaj.

Problemi	Zgjidhja
Pajisja bën shumë zhurmë, lëshon një erë të pakëndshme, duket e nxehtë ose nxjerr tym. Çfarë duhet të bëj?	Pajisja mund të lëshojë një aromë të pakëndshme ose të lëshojë pak tym nëse nuk është përdorur për shumë kohë. Në këtë rast ju duhet ta fikni pajisjen dhe ta lini të ftohet për 60 minuta.
Ka mundësi të dëmtohet pajisja nga përpunimi i përbërësve shumë të fortë?	Po, pajisja mund të dëmtohet nëse përpunoni përbërës shumë të fortë, si për shembull kockat, frutat me bërthamë ose përbërësit e ngrirë.
Pse pajisja ndalon punën në mënyrë të papritur?	Ndonjë përbërës i fortë mund të ketë bllokuar njësinë e thikave. Hiqni spinën e pajisjes, çmontoni njësinë e motorit dhe largoni me kujdes përbërësit që bllokojnë njësinë e thikave.





Specifikimet mund të ndryshojnë pa paralajmërim

© 2020 Koninklijke Philips N.V.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.